



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:078763

Datë: 01.10.2021

Numri i dokumentit: 02234293

P. nr. 102/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarës D. K. nga P., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II. nr. 80/2020, të datës 22.06.2020, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 26.08.2021, në prezencën e prokurorit te shtetit Enis Gashi, të dëmtuarit M. J., të akuzuarës D. K. së bashku me mbrojtësin e saj Halim Shala avokat në Prishtinë, **më 31 gusht 2021 nxjerr dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

E akuzuara **D. K.**, nga i ati N., e ëma Z., e gjinisë I., e lindur më, në fshatin N., Komuna e G., tani për momenti jetoj në P. rruga "B" M. ...numër ..., shqiptare, shtetase e R. së Kosovës, më parë e pa dënuar, e martuar, nënë e 1 fëmije, ka të kryer filloren, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse,

Më datën 11.12.2017, në fshatin K., Komuna e Malishevës, falsifikon dokumentin publik dhe e shfrytëzon si origjinal dhe me vetëdije e përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, në atë mënyrë që e pandehura më datën 09.07.2019, shkon në zyrën e noterit M. J., në S., ku e pandehura D., kërkon nga i dëmtuari noteri M. J., që t'ia lëshoj një autorizim, duke ia prezantuar një autorizim paraprak me nr. LRP. ... të datës 11.12.2017, me pretekst që e pandehura të udhëtoj jashtë vendit me djalin e saj E., pasi që e pandehura e prezanton autorizimin paraprak të lartcekur e ku kërkonte që në saje të këtij autorizimi të i lëshonte edhe një autorizim tjetër, ku me të vërejtur këtë autorizim i dëmtuari konstaton dhe vërteton që autorizimi paraprak në fjalë nuk ishte lëshuar nga ana e tij, i njëjti ishte i falsifikuar, me ç' rast i dëmtuari noteri M. J., menjëherë e paraqet rastin e këtij dokumenti te falsifikuar në polici.

- me çka ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par.2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,6,7,17,41,42,43,46,46 par.3, 62 paragrafi 1 dhe 2 nën par. 2. 7,73,74, 398 par.2 të KPRK-së, dhe neni 248 paragrafi 4,365, 450 par. 1, 2, nën par. 2.6 të KPPK-së, të akuzuarën e,

G J Y K O N

Të akuzuarën **D. K.** e dënon me dënim me gjobë në shumën prej nëntëqind (900) euro, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej dyzet e pesë (45) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2. 7, 69 të KPRK-së, i shqiptohet edhe

DËNIMI PLOTËSUES

KONFISKOHET autorizimi i lëshuar në emrin e noterit M. J. në S. Nr. LRP.

Detyrohet e akuzuara që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,00 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 40,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari M. (H.) J. nga fshati S., Komuna e S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykate ka paraqitur aktakuzë PP/II. nr. 80/2020, të datës 22.06.2020, kundër të akuzuarës D. K. nga P., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 26.08.2021, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurës iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurës se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga e pandehura pasi që është bindur plotësisht se ishte e vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendimin, nuk e kundërshtoj pranimi e fajësisë nga ana e të akuzuarës pasi që e njëjta pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet, pa presion, dhe

pasi që ka kuptuar favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e po ashtu pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e saj, po ashtu duke marrë për bazë që aktakuza ka mbështetje në provat personale dhe materiale, në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv, ku edhe përmbushen të gjitha elemente e veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura.

I dëmtuari M. J. deklaron se: sa i përket dënimit së të akuzuarës këtë ia lë në vlerësim gjykatës, e sa i përket kompensimit këtë do ta shikoj më vonë.

Mbrojtësi i të akuzuarës D. K. av. Halim Shala, deklaron se: i nderuar gjyqtar si përfaqësuesi i D.K. pas konsultimeve të mjaftueshme që kam pasur me klientin tim, dhe pasi që e njëjta është njoftuar më pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë në mënyrë vullnetare ka shpreh gatishmërinë që të pranoj fajësinë duke marrë parasysh që ky pranim i fajësisë gjykata të këtë parasysh dhe i njëjti ti shërbej që gjatë shqiptimit të masës të dënimit të shqiptoj dënim më gjobë në kuadër të mundësive ligjore konform nenit 75 dhe 76 të KPPK-së, konsiderojmë që do të arrihet mjaftueshme efekti dhe qëllimi të cilin e synon drejtësia që D. K., që në të ardhme të mos përsëris veprime të tilla, po ashtu dënimi më gjobë nuk do të ndikonte negativisht në të ardhmen e saj, pasi që është femër dhe ky dënim do të mjaftonte edhe pse ky vlerësim i nderuar gjyqtar është në sekretionin tuaj të keni parasysh se e njëjta bie ndesh për herën e parë para ligjit, është nënë, gjendjen e saj ekonomike dhe mbajtëse e një fëmije si nënë.

E pandehura D. K., deklorohet e fajshëm për akuzën, është hera e parë që e kam kryer, nuk e kam ditur që e njëjta është vepër penale, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris ndonjë vepër tjetër penale, kërkoj falje, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më dënoj më gjobë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka aprovuar deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Nga thëniet e vet të pandehurës në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ajo me datë, kohë dhe vend si në diapozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj saj ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr. dt. 09.07.2019; procesverbal mbi intervistimin e dyshuarit D.K. dhënë në Stacioni Policore në S. nr. dt. 09.07.2019; autorizimi i lëshuar në emrin e noterit M. J. në S. Nr. LRP. ...; raporti policor mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit – dëmtuarit M.J. dhënë në Stacioni Policore në M. nr. ... dt. 09.07.2019; raporti i oficerit P.Z.KPS ... nr. ... dt. 11.07.2019; fotoja e L. K., si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74 të KPRK-së, ashtu që

rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se e pandehura ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është hera e parë që e ka kryer një vepër penale, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëritë vepër tjetër penale, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti në përjashtim të veprës penale të cekur më lartë, Gjykata të akuzuarës i shqiptoi dënim me gjobë në shumën prej nëntëqind (900) euro, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi plotësues mbi konfiskimin e autorizimit i lëshuar në emrin e noterit M. J. në S. Nr. LRP., u more në bazë të nenit 62 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2. 7, 69 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1, 2. 6 të KPPK-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3. 2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P. nr. 102/2020, Datë 31 gusht 2020

Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.